

URDHËR
Nr. 176, datë 2.8.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN PËR SHPALLJEN
DHE PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË
ALBCONTROL-it”**

Bazuar në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 8, të nenit 10, të ligjit nr. 40/2024, “Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror “*Albcontrol*”;

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Albcontrol-it”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR SHPALLJEN DHE PËRZGJEDHJEN E
ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË *ALBCONTROL-it*

Neni 1
Objekti

1.1 Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës për shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues të *Albcontrol-it*.

Neni 2
Parimet e përgjithshme

2.1 Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet sipas një procedure të bazuar në parimin e mosdiskriminimit, meritës, transparencës dhe profesionalizmit.

Neni 3
Ndjekja e procesit

3.1 Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ndjek procesin e shpalljes dhe të kualifikimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Albcontrol-it.

Neni 4

Publikimi i thirrjes

4.1 Me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin vakant të anëtarit të Këshillit Drejtues.

4.2 Thirrja publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

4.3 Në rast të mungesës së konkurrencës apo mos kualifikimit të asnjë prej kandidatëve, procedura e publikimit të thirrjes, përsëritet.

Neni 5

Përbërja e Këshillit Drejtues

5.1 Këshilli Drejtues i *Albcontrol-it* përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, përkatësisht:

- a) specialistë të fushës së transportit ajror;
- b) specialistë të fushës së financës;
- c) specialistë të fushës ligjore.

5.2 Anëtar i Këshillit Drejtues, sipas ligjit nr. 40/2024, “Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror “*Albcontrol*””, mund të përzgjidhet dhe emërohet edhe një personalitet i njohur në fushën e tij profesionale.

Neni 6

Kriteret për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues

6.1 Kandidati për anëtar në Këshillin Drejtues, në përmbushje të kriterëve ligjore, paraqet pranë Ministrisë dokumentacionin si vijon:

- a) kopje të mjetit të identifikimit;
- b) jetëshkrimin;
- c) kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës së nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vjet akademikë në shkenca juridike, ekonomike ose inxhinierike;
- ç) vërtetim që për të nuk është marrë masë disiplinore për largim nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- d) kopje të librezës së punës të njehsuar me origjinalin;
- dh) dëshmi penaliteti;
- e) vërtetim mjekësor që është i aftë për punë;
- ë) vetëdeklarim se nuk gjendet në konflikt interesi me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Procedura e verifikimit dhe e përzgjedhjes

7.1 Kandidatët përcjellin dokumentacionin zyrtarisht pranë Drejtorisë së Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, brenda një afati prej 5 (pesë) ditë-pune nga data e shpalljes së thirrjes.

7.2 Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, verifikon brenda 2 (dy) ditë-pune nga paraqitja e

dokumentacionit, nëse kandidatët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 6.1 të kësaj Rregulloreje.

7.3 Nëse struktura përgjegjëse për burimet njerëzore konstaton se dokumentacioni i paraqitur ka mangësi, e njofton kandidatin në rrugë elektronike për plotësimin e tyre brenda një afati prej 2 (dy) ditë-pune.

7.4 Pas shqyrtimit të dokumentacionit, struktura përgjegjëse harton dhe përcjell pranë ministrit listën e kandidaturave dhe një relacion përmbledhës për secilin kandidat.

7.5 Ministri për zgjedh kandidatët fitues nga lista e paraqitur nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore.

Neni 8

Njoftimi i kandidatit fitues

8.1 Kandidatët fitues njoftohen me shkrim dhe shpallen në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.